

## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME 2021

online

### 1. Fjala e Presidentit

Zonja dhe zotërinj, administratorë  
Të nderuar anëtarë,

Së pari, unë do të doja t'ju falenderoja për praninë tuaj në këtë Asamble të Përgjithshme, një prani sigurisht jo fizike por virtuale, duke pasur parasysh krizën shëndetësore që po përjeton bota.

Dhoma jonë është në të njëjtën situatë si shumica e kompanive në botë: Ne do të paraqesim aktivitetin për vitin 2020 i cili është i kënaqshëm, por nuk mund të anashkalojmë ndikimin e krizës shëndetësore e cila prek të gjithë Dhomën tonë. Kështu që e gjejmë veten të kapur në një situatë paradoksale.

- Lidhur me projektet e ardhshme të Dhomës, jam i lumtur t'ju informoj se **le Congrès National Français des Entreprises du Voyage qui compte plus de 1000 agences de voyages en France** i cili fillimisht u planifikua në Tiranë nga 29 maj deri më 1 qershor 2020 por u shty për shkak të krizës globale të shëndetit, do të zhvillohet gjatë qershorit 2021 në Tiranë. Kryetari i Këshillit të sindiaktës së Kompanive të Udhëtimit Jean-Pierre Mas ka shprehur qartë gatishmërinë e tij për të ndjekur programin në Shqipëri.
- Gjithashtu, në janar të vitit 2021 unë takova në Paris **CEO-n e grupit L'ORÉAL, Z. Jean Paul AGON**, Presidentin e Këshillit (për Shqipërinë) të MEDEF INTERNATIONAL, për të përgatitur vizitën në Shqipëri të një grupi **industrialistësh francezë**, vjeshtën e ardhshme, me qëllim studimin mundësisë së krijimit të kompanive franceze që dëshirojnë të riatdhesojnë në Europë prodhime të zhvendosura në Kinë.

Aspekti më formal i kësaj Asambleje të Përgjithshme nuk duhet të neglizhohet, sepse do të na mundësojë të bëjmë një përmbledhje të aktiviteteve tona për vitin 2020 dhe të diskutojmë mbi reflektimet dhe rrugët e punës për 2021 në kontekstin e vështirë që po përjetojmë.

Gjithashtu do të kemi kënaqësinë të dëgjojmë drejtpërdrejtë ndërhyrje nga kandidatët e Këshillit për periudhën 2021-2023 si dhe raportin e aktivitetit për vitin 2020 dhe raportin financiar nga Përgjegjësi i Thesarit.

Ne gjithashtu do të mirëpresim tre anëtarë të rinj në Dhomën tonë: Ylliad, Compagnie européenne des services industriels du BTP dhe Voltalia Albania. Dua t'i përshëndes të tre dhe t'i përgëzoj për ardhjen.

Dua të theksoj se 46 anëtarë kanë rinovuar anëtarësimin e tyre të plotë për vitin 2020 dhe 38 janë të pranishëm sot, kompani të pranishme ose të përfaqësuara. Duke qenë se kuorumi i anëtarëve të pranishëm është 38, tashmë është arritur.

Kjo Asamble e Përgjithshme është me zgjedhje dhe votimi e numërimi do të bëhet në prani të një noteri, zonjës Lorena Shkjezi-Karafili, dygjuhësh, shqip dhe frëngjisht.

- Gjithashtu, unë do të doja të falënderoja në emrin tim dhe në emër të të gjithë anëtarëve SHS Ambasadorin e Francës Elisabeth Barsacq për pranimin e postit të Kryetarit të Nderit të Dhomës sonë.

Mirësevini Zonja Ambasadore dhe Presidente Nderi, dhe pa pritur më gjatë, unë ju jap fjalën.

Tani do të hyj në fazën më institucionale të kësaj Asambleje të Përgjithshme të zakonshme duke propozuar së pari miratimin e pikës 3 të rendit të ditës:

**Pika 3 :** Vendim për zgjatjen dymbëdhjetë mujore të mandatit të anëtarëve të Bordit në fuqi.

Të gjithë janë informuar me email se duke pasur parasysh krizën shëndetësore dhe vonesën në gjykatë për validimin e statuteve, Dhoma nuk mundi të organizonte AP vitin e kaluar.

*(Statutet e dërguara për validim në Gjykatë në fund të vitit 2019 u validuan në Mars 2021)*

Tani do t'i jap fjalën Blerina Kazhanit, Drejtoresha jonë Ekzekutive për prezantimin e raportit të aktiviteteve 2020 dhe strategjinë 2021.

Siç do ta shihni nga leximi i raportit, rrjeti ynë vazhdoi të zhvillohej me një ritëm të mirë në vitin 2020

---

## 2. Tani po prezantoj kandidatët për postet e KD 2021-2023

Kjo Asamble e Përgjithshme bën të mundur rinovimin e Bordit të Administrimit, pra 7 pozicione.

Këto zgjedhje fillimisht morën 9 kandidatura të cilat u dërguan me email.

Këto votime bëhen me votim të fshehtë, një votë për anëtar.

Votimi dhe numërimi do të bëhet nën mbikëqyrjen e një noteri, Znj. Lorena Shkjezi-Karafili.

## **Unë po prezantohem për postin e Presidentit**

### **Përse unë dëshiroj që të rizgjidhem President?**

Të nderuar anëtarë,

Unë po kandidoj përsëri për presidencën e CCI-së tonë së pari sepse jam krenar që punoj këtu me ju dhe dua të jap kontributin tim për të shërbyer me vizionin tim Franko-Shqiptar për anëtarët tanë, bizneset dhe komunitetin francez. Ky vit që po vjen do të jetë shumë i ndërlikuar dhe do të kërkon shume pune, pasi shumë prej anëtarëve tanë janë - ose do të detyrohen - të na braktisin për shkak të vështirësive financiare. Ne duhet t'i ndihmojmë ata të gjejnë alternativa dhe t'i kthejmë tek ne. Ndoshta një vit "i bardhe" për sa i përket kontributeve tashmë të reduktuara për t'i ndihmuar ata. Vendimi përfundimtar do të merret nga Këshilli i ri Drejtues.

Unë do të vazhdoj të punoj që anëtarët dhe partnerët tanë të merren në konsideratë, dhe që të ketë rregullisht diskutime mbi përgjegjësinë ligjore me rëndësi. Objektivi im kryesor dhe ai i Këshillit është që të mobilizojmë udhëheqësit tanë politikë mbi nevojën për të mbështetur dhe inkurajuar më tej kompanitë franceze për t'u implementuar në Shqipëri dhe për të zhvilluar më tej biznesin e tyre.

CCI është një pikë bashkimi për shoqëritë franceze në kërkim të informacionit mbi Shqipërinë dhe anasjelltas. Ju e dini që në Dhomën tonë dhe në Këshillin tonë Drejtues kemi anëtarë të cilët janë gjithashtu Këshilltarë të Tregtisë së Jashtme Franceze. Rrjetet tona bashkëpunojnë ngushtazi. Ju ftoj të aplikoni, nëse dëshironi, për të gjithë postet, përfshirë presidencën dhe vota demokratike do të fitojë.

Ekipi i CCI dhe unë, do të jemi edhe më të vëmendshëm ndaj nevojave tuaja; do t'ju sjellim përgjigjet e duhura ose do transmetojmë pritshmëritë tuaja pranë autoritetet publike. Dera ime është gjithmonë e hapur për të gjithë anëtarët tanë, veçanërisht në kohë të vështira. Suksese të gjithëve.

**Ftoj Zgjidh Mita** të prezantohet për pozicionin e Zevendeskrjetarit. Faleminderit, 2 minuta

**Ftoj Jean Alain Jouan**, i cili mungon, por përfaqësohet nga Blerina Kazhani, të prezantohet për pozicionin e Zevendeskrjetarit. Faleminderit, 2 minuta

**Ftoj Patrick Pascal** të prezantohet për pozicionin e Zevendeskrjetarit. Faleminderit, 2 minuta

**Ftoj Diana Ylli** të prezantohet për postin e Përgjegjësit të Thesarit. Faleminderit, 2 minuta.

**Ftoj Florian Hasko** të prezantohet për postin e Anëtarit të Këshillit Drejtues. Faleminderit, 2 minuta.

**Ftoj Eni Kalo** të prezantohet për postin e Anëtarit të Këshillit Drejtues. Faleminderit, 2 minuta.

**Ftoj Odhise Zoto** të prezantohet për postin e Anëtarit të Këshillit Drejtues.  
Faleminderit, 2 minuta.

**Ftoj Gjergji Themeli** të prezantohet për postin e Anëtarit të Këshillit Drejtues.  
Faleminderit, 2 minuta.

**President: (1)**

- 1) Julien Roche

**Zëvendës-Presidentë (3)**

- 1) Zgjim Mita/Automita
- 2) Jean Alain Jouan/Aleat
- 3) Patrick Pascal/Selenice Bitumi

**Thesari : (1)**

- 1) Diana Ylli/Mazars

**Anëtarë të Këshillit Drejtues: (4)**

- 1) Florian Hasko/Tashko Pustina
- 2) Eni Kalo/Kalo&Associates
- 3) Odhise Zoto/ACTI shpk
- 4) Gjergji Themeli/Albinfos

**3. Rezultatet e votimeve për Këshillin e Administrimit**

Zgjidhen :

**President:**

1. Julien Roche

**Zëvendës-Presidentë:**

1. Zgjim Mita , Renault AutoMita
2. Jean Alain Jouan, Aleat Groupe Idemia
3. Patrick Pascal, Selenice Bitumi

**Thesari :**

1. Diana Ylli, Mazars

**Anëtarë të Këshillit Drejtues:**

1. Florian Hasko, Tashko Pustina
2. Eni Kalo, Kalo&Associates
3. Odhise Zoto, A.C.T.I shpk
4. Gjergji Themeli, Albinfos

« Deklaroj të mbyllur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Doja të falënderoja të gjithë të zgjedhurit dhe anëtarët për punën e tyre të përditshme dhe gjithashtu për pjesëmarrjen në këtë Asamble.

Shihemi së shpejti. Faleminderit të gjithëve! »